



---

REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E BRENDSHME  
QENDRA E PRITJES PËR AZIL

**RAPORTI VJETOR  
QENDRA E PRITJES PËR AZIL**

**VITI 2021**



## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>HYRJE.....</b>	<b>III</b>
<b>STATUSI JURIDIK I QPA-SË DHE STRUKTURA.....</b>	<b>- 1 -</b>
☛ <b>Struktura e QPA-së dhe organigrama.....</b>	<b>- 1 -</b>
☛ <b>Organigrama e Qendrës së Pritjes për Azil.....</b>	<b>- 1 -</b>
<b>REALIZIMET SIPAS PRIORITETEVE TË MINISTRISË SE BRENDSHME.....</b>	<b>- 2 -</b>
<b>Sektori i Mbështetjes së Azilkërkuesve.....</b>	<b>- 3 -</b>
☛ <b>Bashkëpunimi me struktura të Policisë së Shtetit dhe Bashkisë Kamëz.....</b>	<b>- 5 -</b>
☛ <b>Njohja e azilkërkuesve me të drejtat dhe detyrimet e tyre si dhe procedurat e azilit.....</b>	<b>- 6 -</b>
☛ <b>Masat e marra për parandalimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.....</b>	<b>- 6 -</b>
☛ <b>Aktivitete të realizuara.....</b>	<b>- 7 -</b>
<b>Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.....</b>	<b>- 7 -</b>
☛ <b>Realizimi i zërave të buxhetit për vitin 2021.....</b>	<b>- 7 -</b>
<b>Burimet njerëzore.....</b>	<b>- 9 -</b>
☛ <b>Sistemi e HRMSI.....</b>	<b>- 9 -</b>
☛ <b>Trajnimet.....</b>	<b>- 9 -</b>
☛ <b>Realizimi i zërave të procedurave të prokurimit për vitin 2021.....</b>	<b>- 9 -</b>
<b>PROBLEMATIKAT E HASURA NE PUNËN E QPA-SË, GJATË VITIT 2021.....</b>	<b>- 11 -</b>
<b>ARRITJE.....</b>	<b>- 11 -</b>
<b>PRIORITETET/OBJEKTIVA DHE MASAT ME RËNDËSI NË AKTIVITETIN E QPA-SË PËR VITIN 2022.....</b>	<b>- 12 -</b>

## HYRJE

Raporti Vjetor 2021 i Qendrës së Pritjes për Azil është një dokument gjithë përfshirës i punës dhe aktiviteteve institucionale si dhe rezultateve të arritura, duke zbatuar kuadrin ligjor në fuqi. Raporti paraqet zhvillimet kryesore në Qendrën e Pritjes për Azil, si dhe jep rekomandime për përmirësimin e performancës së institucionit. Disa prej çështjeve kryesore të trajtuara në raport janë: statusi ligjor dhe struktura e institucionit, realizimi i buxhetit për vitin 2021 dhe aktivitetet institucionale. Kjo përmbledhje, shfaq jo vetëm objektivat dhe rezultatet e arritura, por gjithashtu nxjerr në pah problematikën me të cilën Qendra është ndeshur gjatë vitit raportues.

Qendra ka për mision respektimin e legjislacionit të brendshëm dhe atë ndërkombëtar të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, me fokus ato të azilkërkuesve dhe refugjatëve si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të shërbimeve të ofruara për azilkërkuesit dhe refugjatët e akomoduar.

Gjashtë mujori i parë i vitit 2021 ka qenë në fakt tejte i rëndësishëm dhe sfidues për Qendrën pasi shënoi një numër të moderuar azilkërkuesish të akomoduar, me shtetësi të ndryshme, kryesisht nga Siria dhe Afganistani. Prioriteti i punës sonë ka qenë dhe mbetet mbarëvajtja dhe organizimi i pritjes së tyre, akomodimi dhe ofrimi i shërbimeve të domosdoshme, si dhe informimi i tyre me masat për mbrojtjen nga përhapja e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19. Azilkërkuesit u informuan nëpërmjet komunikimit edhe posterave të afishuara në ambientet e Qendrës (në gjuhën angleze, farsi, arabe) dhe u pajisën me bazë materiale si maska mbrojtëse, doreza dhe dezinfektues me bazë alkooli, me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit.

Ndër objektivat e Qendrës ka qenë edhe administrimi me efektivitet i fondeve buxhetore dhe burimeve financiare duke ndjekur zbatimin e planifikimit të fondeve buxhetore miratuar për vitin 2021 dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërveprimi me të gjitha strukturat që operojnë në fushën e migracionit dhe azilit.

QPA, jo vetëm gjatë vitit raportues, por edhe në vazhdim, angazhohet në zgjidhjen e sfidave të ardhshme, duke u udhëhequr nga përgjegjshmëria, integriteti dhe transparenca për të punuar me përkushtim e seriozitet drejt cilësisë së shërbimeve e përmbushjes së standardeve më të larta sa i takon shërbimeve të ofruara për azilkërkuesit/refugjatët.

## **STATUSI JURIDIK I QPA-SË DHE STRUKTURA**

Qendra e Pritjes për Azil është institucion ku akomodohen dhe trajtohen persona të huaj me apo pa shtetësi që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në Shqipëri në respektim të legjislacionit të brendshëm dhe ndërkombëtar të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, me fokus ato të azilkërkuesve dhe refugjatëve.

Funksionon në varësi të Ministrisë së Brendshme nga viti 2004, me VKM Nr. 262, datë 23.04.2004 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit, në Babrru, Tiranë, Ministrisë së Rendit Publik, si dhe për organizimin e funksionimit të saj dhe për shtesë në numrin e parashikuar të punonjësve të kësaj ministrie”.


Aktualisht Qendra e Pritjes për Azil funksionon sipas strukturës së miratuar më Urdhër të Kryeministrit Nr. 79, datë 21.02.2014 dhe VKM-së Nr. 630, datë 27.10.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Pritjes për Azil”.

- **Struktura e QPA-së dhe organigrama**

Qendra e Pritjes për Azil është e organizuar në dy sektorë me përbërje prej 15 punonjës:

- 1- Titullari i Institucionit.
- 2- Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse me 11 punonjës.
- 3- Sektori i Mbështetjes së Azilkërkuesve me 3 punonjës.

- **Organigrama e Qendrës së Pritjes për Azil**



## **REALIZIMET SIPAS PRIORITETEVE TË MINISTRISË SE BRENDSHME**

Gjatë vitit 2021, Qendra e Pritjes për Azil ka punuar me impenjimin dhe profesionalizmin e duhur për realizimin e detyrave dhe objektivave sipas përgjegjësive që përcaktohen në aktet ligjore dhe ato normative që rregullojnë funksionimin e institucionit.

Në kuadër të objektivave dhe detyrave të përcaktuara në dokumentin e prioriteteve të Ministrisë së Brendshme për vitin 2021, paraqitet në mënyrë të përmbledhur veprimtaria për këtë periudhë:

1. Është bërë analiza dhe programimi për rialokimin e fondeve sipas nevojave emergjente të institucionit dhe ndryshimet në zërat në Regjistrin e Planifikimit të procedurave të prokurimit për vitin 2021.
2. Është hartuar Projekt-buxheti Afatmesëm për vitet 2022-2024, ku janë bashkëngjitur kërkesat shtesë:
  - Ndryshimin e strukturës së QPA-së nga 15 punonjës në 21 punonjës.
  - Shpenzime operative (Furnizime dhe shërbime me ushqim për mencat).
  - Blerje materiale për akomodimin e azilkërkuesve.
  - Mur rrethues dhe punime sistemimi të sheshit për objektin “Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit”.
3. Është realizuar Rikonstruksion i godinës së QKPA-së.
4. Janë hartuar e miratuar programe pune, raporte mujore dhe raporte të tjera periodike, të cilat pasqyrojnë objektivat kryesore, punën e kryer në përmbushje të tyre, burimet dhe kapacitetet e angazhuara dhe tregues të tjerë për institucionin.
5. Është plotësuar e përditësuar dosja personale për çdo punonjës, me gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor e administrativ. Përditësohen periodikisht Regjistri i Punëmarrësit dhe ndiqet dinamika e pasurimit të dosjeve me vlerësime periodike, praktika disiplinore, vjetërsi në punë e procedura të tjera që shoqërojnë punonjësën gjatë veprimtarisë së punës.
6. Është ndërtuar një procedurë e rregullt administrative e ligjore, sa i përket emërimeve të punonjësve të rinj, praktikave disiplinore dhe atyre të lirimit nga detyra. Për çdo rast, plotësohet sipas standardeve dokumentacioni i duhur dhe ndiqen etapat përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7. Sistemi HRMIS është plotësuar në çdo rubrikë; në vazhdimësi janë bërë përditësimet e duhura sipas dinamikës së lëvizjeve të personelit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga punonjësit.
8. Janë marrë masat e duhura për të rritur sigurinë dhe mbrojtjen në punë sipas standardeve ligjore. Pajisjet fikëse të zjarrit janë të mbushura dhe brenda afatit të skadencës, janë të kolauduara dhe janë në gatishmëri për çdo emergjencë të mundshme.
9. Organizimi dhe mirëmenaxhimi i situatës së pandemisë, me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, QPA ka marrë masa si për punonjësit edhe për të akomoduarit në Qendër, duke iu mundësuar maska mbrojtëse, doreza dhe dezinfektues me bazë alkooli. Gjithashtu janë realizuar dezinfektime të mjediseve të QPA-së. Azilkërkuesit u informuan në lidhje me masat me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit, realizuar nëpërmjet komunikimit dhe posterave të afishuara në ambientet e Qendrës (në gjuhën angleze, farsi, arabe, dari dhe pashtu), në zbatim të Aktit Normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të

Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”, të ndryshuar.

### Sektori i Mbështetjes së Azilkërkuesve

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021, Qendra e Pritjes për Azil ka pritur dhe akomoduar në total 78 azilkërkues sipas statistikave të mëposhtme:

- o 47 të rritur, ku nga këto 19 janë femra dhe 28 meshkuj; 31 të mitur, përkatësisht 17 vajza dhe 14 djem.


Muaji	0 -18vjeç		Mbi 18 vjeç (të rritur)		Totali
	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	
Janar-Dhjetor 2021	17	14	19	28	78
Janar-Dhjetor 2020	173	334	319	1363	2189
Janar-Dhjetor 2019	532	1070	829	4269	6700

- o 31 janë minorenë të shoqëruar dhe 0 janë minorenë të pashoqëruar.


Muaji	Minoren	
	Të shoqëruar	Të pashoqëruar
Janar-Dhjetor 2021	31	0
Janar-Dhjetor 2020	472	35
Janar-Dhjetor 2019	1478	124

Për sa i përket numrit të minorenëve të pashoqëruar, të akomoduar raportohen 0 minorenë të pashoqëruar të akomoduar në Qendër gjatë vitit 2021.


Sipas një krahasimi të bërë, vihet re se gjatë tre viteve të fundit numri i azilkërkuesve të akomoduar është i moderuar. Koncretisht numri i azilkërkuesve të akomoduar në periudhën Janar-Dhjetor 2019 është 6700, numri i azilkërkuesve të akomoduar në periudhën Janar-Dhjetor 2020 është shumë më i lartë në krahasim me periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2021 ku koncretisht në periudhën Janar-Dhjetor 2020 janë akomoduar 2189 persona dhe në periudhën Janar-Dhjetor 2021 janë akomoduar 78 persona.



Grafiku tregon se gjatë periudhës, Janar-Dhjetor 2021 në muajin Janar dhe Qershor numri i azilkërkuesve të akomoduar është më i lartë në krahasim me muajt e tjerë.



Grafiku tregon se gjatë periudhës, Janar-Dhjetor 2021 familjet e akomoduar kanë qënë 17 familje ku 44% prej tyre me origjinë nga Siria, 50% e tyre me origjinë nga Afganistani 6% e tyre me origjinë nga Egjipti.



Gjashtë prej azilkërkuesve të akomoduar, me kërkesën e tyre janë zhvendosur jashtë Qendrës me mbështetjen e UNHCR-së dhe RMSA-së për ndjekjen e procedurave përkatëse për azil. Tabela e mëposhtme paraqet një pamje më të qartë.

NR.	SHTETËSIA	PERSONA	MESHKUJ	FEMRA
1	Siri	4	2	2
2	Siri	2	2	-
<b>TOTALI</b>		<b>6</b>	<b>4</b>	<b>2</b>

● **Bashkëpunimi me struktura të Policisë së Shtetit dhe Bashkisë Kamëz.**

- Bashkëpunimi me strukturat e Policisë ka qënë i vazhdueshëm dhe shumë efikas, i cili ka qënë i domosdoshëm për koordinimin e informacionit midis strukturave përkatëse.
- Bashkëpunimi me Drejtorinë e Azilit dhe Shtetësisë në Ministri, për problemet e statusit të azilkërkuesve.
- Ndër organizatat me të cilat bashkëpunon Qendra janë; UNHCR, RMSA, ILO, Caritas Albania, GIZ, Qendra Ura. UNHCR dhe RMSA kanë mundësuar shërbimin mjekësor me një infermiere. Konkretisht gjatë kësaj periudhe këtë shërbim e kanë marrë shumë azilkërkues. Infermierja ka ofruar shërbimin e parë dhe ka asistuar në shoqërimin e tyre në qendra të

ndryshme shëndetësore dhe spitalore. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021 janë ofruar 430 shërbime shëndetësore.

- Për të krijuar një mjedis sa më argëtues dhe relaksues për fëmijët në qendër ndodhet një dhomë posaçërisht për ta, e quajtur “Dhoma e fëmijëve”. Punojësit e Sektorit të Mbështetjes së Azilkërkuesve çdo ditë bëjnë të mundur shoqërimin e fëmijëve duke krijuar lojëra argëtuese dhe zhvilluese për ta. Përpos dhomës së fëmijëve Qendra ofron gjithashtu edhe sallën e internetit, ku azilkërkuesit mund të aksesojnë në internet dhe të komunikojnë me familjarët e tyre. Psikologjia ka bërë vlerësime psikologjike dhe psikosociale.

- **Njohja e azilkërkuesve me të drejtat dhe detyrimet e tyre si dhe procedurat e azilit**

Në momentin e akomodimit azilkërkuesit njihen me rregullat e brendshme të kësaj Qendre si dhe të drejtat dhe detyrimet që ata kanë. Më pas u lind e drejta për të marrë informacion mbi vazhdimësinë e procedurave për azil, njëkohësisht u shpërndahet një fletëpalosje në gjuhën angleze dhe arabe.

- **Masat e marra për parandalimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.**

Qendra e Pritjes për Azil është një Qendër e hapur ku personat janë të lirë të lëvizin gjatë orarit 10:00-22:00. Gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit, QPA ka marrë disa masa si për punonjësit edhe për azilkërkuesit e akomoduar në Qendër, duke mundësuar maska mbrojtëse, doreza dhe dezinfektues me bazë alkooli. Azilkërkuesve u janë treguar masat që duhet të marrin me qëllim parandalimin e përhapjes së sëmundjes. Kjo u është shpjeguar si nëpërmjet komunikimit, e cila është bërë në gjuhën angleze, ashtu edhe nëpërmjet posterave të ngjitur në Qendër (këto në gjuhën angleze, arabe, farsi). Gjithashtu është realizuar dezinfektimi i mjedisve të QPA-së, dhomave akomoduese, mjediset e përbashkëta dhe zyrat e administratës.

Me qëllim mbrojtjen e shëndetit të azilkërkuesve dhe kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-19, në zbatim të ligjit nr.10/2021 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë” Ministria e Brendshme është shprehur me Vendim Nr.12, datë 03.04.2020 “Për Kufizimin e lëvizjes së Azilkërkuesve në Republikën e Shqipërisë”.

Në kuadër të situatës së krijuar nga COVID-19, bazuar edhe në nevojat e Qendrës, të cilat i kemi adresuar pranë Ministrisë së Brendshme, Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), në kuadër të projektit Pact, ofroi mbështetjen për azilkërkuesit/refugjatët e akomoduar në Qendër me materiale si; maska, doreza, alkool dhe dezinfektant xhel.

- **Aktivite të realizuara**

Gjatë vitit 2021 organizata të ndryshme kanë bashkëpunuar me Qendrën në ditë festash për t'ju sjellë azilkërkuesve dhe refugjatëve një ditë ndryshe.

- Gjatë muajit Dhjetor, në kuadër të “Vitet të Ri”, me datë 21.12.2021 RMSA me UNHCR zhvilluan aktivitete dhe lojra për fëmijët dhe shtetasit e akomoduar në Qendër gjithashtu me datë 29.12.2021, Caritas Albania zhvilloi një drekë pranë ambienteve të Qendrës ku u krijua një ambient ndërveprues ndërmjet stakeholder-save të përfashirë në adresimin e nevojave të azilkërkuesve dhe shtetasit e akomoduar në Qendër.


## **Spektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse**

Hartimi, planifikimi, menaxhimi eficientë dhe efektiv i buxhetit për plotësimin e nevojave të azilkërkuesve/refugjatë merr një rëndësi të veçantë për institucionin tonë. Përsa i përket zbatimit të buxhetit, fondi i akorduar në fillim të vitit 2021, në nivel artikulli për njësinë shpenzuese QPA, është në total 37.075.000 lekë i njëjti buxhet me vitin 2021. Kjo vlerë është e detajuar sipas zërave të shpenzimeve të strukturës buxhetore e paraqitur dhe në tabelën e realizimit të mëposhtëm.

- **Realizimi i zërave të buxhetit për vitin 2021**

**Realizimi i zërave të buxhetit për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021 janë sipas pasqyrës së mëposhtme:**

<b>Nr.</b>	<b>Art</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Plani vjetor 2021</b>	<b>Plani me ndryshime</b>	<b>Realizimi vjetor 2021</b>	<b>Diferenca</b>	<b>Realizimi ne %</b>
1	600	Paga,shpërblime dhe te tjera shpenzime personeli	10.200		9.017	1183	88 %
2	601	Kontribute për sigurime shoqerore e shëndetësore	1.700		1.503	197	88 %
3	602	Mallra e shërbime	19.555		16.845	2710	86 %
4	606	Transferta për buxhete familjare individ	5.620	+ 80	5.694	6	100%
5	231	Investime		38.134	<b>38.134</b>		100 %
		<b>TOTALI</b>	37.075	+ 38.214	71.193	4.096	95 %



Bazuar në VKM Nr. 581, datë 10.08.2011 “Për dhënie ndihme financiare një kategorie personash të strehuar në Republikën e Shqipërisë” dhe të Udhëzimit Nr. 33, datë 24.02.2012 “Për dhënien ndihmë financiare një kategorie personash të strehuar në Republikën e Shqipërisë”, në buxhetin e QKPA-së është parashikuar për vitin 2021 në shumën prej 5.620.000 lekë për të mbuluar dhënien e ndihmës financiare për gjashtë familje për pagesën e qerasë së banesës, të ushqimit, energjisë elektrike dhe të ujit është realizuar në masën 100%.

Gjatë vitit 2021 janë bërë ndryshime (shtesa) fondesh në krahasim me akordimin fillestar të buxhetit. Këto ndryshime janë bërë në artikullin 606 “Transferim fond i vecante” në shumën 80.000 lekë, dhe në artikullin 231 Akt-kolaudimi “Rikonstruksion i Godinës së QKPA-së”, në vlerën totale 38.134.254 lekë.

Është bërë rakordimi i fondeve dhe me ndryshimet që kanë pësuar zërat gjatë periudhës së vitit 2021 me degën e thesarit, duke pasqyruar transaksionet e kryera deri në nivel nënartikulli sipas strukturës dhe klasifikimit buxhetor.

Ndjekja, realizimi dhe raportimi i buxhetit është bërë nëpërmjet evidencave progresive të realizimit të buxhetit ku për çdo muaj raportohet në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

- Detyrime të prapambetura për periudhën Janar – Dhjetor 2021**

Nr.	Subjekti	Detyrimi i prapambetur nga viti 2021
1	Subjektit ”Engineering Studio shpk” Akt-Kolaudim “Rikonstruksion i Godinës së Q.K.P.A- së”	60.000 lekë

Ky detyrim i prapambetur i vitin 2021, ka mbetur për arsye të mos celjes se fondeve në zërin investime Akt-Kolaudim“Rikonstruksion i Godinës së Q.K.P.A- së”.

## **Burimet njerëzore**

QKPA-ja ka ndjekur në vazhdimësi respektimin e strukturës së miratuar me VKM-në nr.332, datë 04.05.2016 “Për organizmin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit”, përsa i përket numrit të punonjësve.Struktura e QKPA-së përbëhet nga 15 punonjës, të cilët trajtohen sipas Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë. Gjatë vitit 2021 janë paraqitur katër dorëheqje. Është proceduar për plotësimin e vendeve vakant.

### **• Sistemi e HRMSI**

Janë hedhur në sistem të dhënat e punonjësve me adresa, nr telefoni, e-maile, ID, nr llogarie, profesioni, kualifikimet etj. Tashmë çdo punonjës arsimor i ka të dhënat online në këtë sistem, në lidhje me të dhënat personale, emërimin në punë sipas pozicionit, edukimin, kualifikimet, nivelin e gjuhës së huaj, përvojën e punës etj. Ky sistem ndihmon më shumë në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe rrit transparencën. Sistemi HRMIS përditësohet me të dhënat e punonjësve.

### **• Trajnimet**

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve profesionale të stafit , të aftësive menaxhuese dhe funksionale të punonjësve në funksion të procesit të standardizimit të kujdesit dhe shërbimeve të ofruara, u mundësua pjesëmarrja e punonjësve në disa trajnime të organizuara nga organizata të ndryshme dhe ASPA.

Gjatë vitit 2021 janë realizuar 2 trajnime:

- 16 shtator 2021 UNHCR realizoi trajnimin me temë “ Çështje të Mbrojtjes së Fëmijëve”.
- 17 dhjetor 2021 ILO realizoi trajnimin mbi çështjet e punësimit të azilkërkuesve në RSH.

### **• Realizimi i zërave të procedurave të prokurimit për vitin 2021**

<b>Nr.</b>	<b>Objekti i Prokurimit</b>	<b>Vlera e kontratës</b>	<b>Organi i financimit</b>
<b>1.</b>	Kancelari 2	77,776	Buxheti i Shtetit
<b>2.</b>	Materiale Pastrimi Detergjente 4	125,000	Buxheti i Shtetit
<b>3.</b>	Blerje tonera per printera	99,600	Buxheti i Shtetit
<b>4.</b>	Gaz	175,000	Buxheti i Shtetit

5.	Uniforma dhe Veshje	764,000	Buxheti i Shtetit
6.	Dizinfektimi	149,530	Buxheti i Shtetit
7.	Ene Kuzhine	548,333	Buxheti i Shtetit
8.	Ushqim per menca	245,872	Buxheti i Shtetit
9.	Blerje Dyshekesh	870,000	Buxheti i Shtetit
10.	Ushqim per menca	46,583	Buxheti i Shtetit
11.	Elektricitet	1,746,449	Buxheti i Shtetit
12.	Uje	500,617	Buxheti i Shtetit
13.	Internet	47,416	Buxheti i Shtetit
14.	Posta dhe Korrier	4,110	Buxheti i Shtetit
15.	Sherbimi i sigurimit dhe ruajtjes	6,551,443	Buxheti i Shtetit
16.	Sherbim per pastrim e gjelberim	90,320	Buxheti i Shtetit
17.	Riparim Cisterme	99,000	Buxheti i Shtetit
18.	Karburant dhe vaj	999,883	Buxheti i Shtetit
19.	Shpenzime te Siguracioneve te mjeteve te transportit	74,121	Buxheti i Shtetit
20.	Riparim Porte	94,700	Buxheti i Shtetit
21.	Shpenzime te tjera transporti (larje makine)	82,800	Buxheti i Shtetit
22.	Riparim Kondicioneri	98,355	Buxheti i Shtetit
23.	Shpenzime për mirembajtjen e mjeteve te transportit	250,000	Buxheti i Shtetit
24.	Sherbimi i mirembajtjes se kanalizimeve ujrave te zeza te ambientit te qendres	90,600	Buxheti i Shtetit
25.	Shpenzime per mjetet e Transportit	197,300	Buxheti i Shtetit
26.	Blerje Kutit dhe dosje per ruajtje te perheshme ne protokoll	250,900	Buxheti i Shtetit
27.	Blerje materiale ndricimi dhe hid 4	90,000	Buxheti i Shtetit
28.	Blerje Fidane dhe Lule	89,000	Buxheti i Shtetit
29.	Shpenzime per tatime e taksa te paguara nga institucioni	43,000	Buxheti i Shtetit
30.	Dizinfektimi anti-Covid	95,601	Buxheti i Shtetit
31.	Blerje Kancelarie	69,750	Buxheti i Shtetit

## **PROBLEMATIKAT E HASURA NE PUNËN E QPA-SË, GJATË VITIT 2021**

- Mungesa e specialistëve të fushës brenda QPA-së për hartimin e standardeve, përshkrimin e specifikimeve teknike të disa objekteve të prokurimit (mallra/shërbime), sjellë si domosdoshmëri bashkëpunimin me Ministrinë e Brendshme ose me institucione të varësisë.
- Duke qenë se ofrohet shërbim 24/7 edhe gjatë fundjavës përfshirë edhe ditët e festave zyrtare dhe referuar numrit të pamjaftueshëm të punonjësve në strukturën e QPA-së, hasim vështirësi

në përfitimin e ditëve të pushimit sipas Kodit të Punës nga ana e specialistëve të sektorit të mbështetjës së azilkërkuesve.

- Mungesa e mjekut dhe infermierit në strukturën e QPA-së, për t'u asistuar në qendër dhe për të dhënë ndihmën e parë azilkërkuesve/refugjatëve, duke i shoqëruar dhe transportuar në çdo kohë pranë qendrave shëndetësore dhe spitalore, përkthyer në kosto në transport, në kohë dhe në punonjës, pasi në shoqërimin e të sëmurit në urgjencë, në spital apo në qendrën shëndetësore në lagje, punonjësit i duhet të shkëputet nga problemet e shumta të cilat ndërkohë duhet t'i ndjekë në Qendër.
- Mirëmbajtësi është i domosdoshëm për kryerjen e riparimeve dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe materialeve të ndryshme në ambientet e akomodimit dhe ambientet e tjera ndihmëse.
- Me urdhrin nr. 363, dt.12.04.2019 të Ministrit të Brendshëm është miratuar regjistri elektronik (Data Base) të dhënat e të cilit funksionojnë në mënyrë integrale midis tri strukturave: Drejtorisë së Azilit dhe Shtetësisë, Departamentit të Kufirit dhe Migracionit dhe QPA-së. Gjatë përdorimit të regjistrit elektronik (Data base) shpeshherë janë hasur mosrakovime shifrash të cilat vijnë për shkak të moshedhjes së të dhënave nga përdoruesit e tjerë.

## **ARRITJE**

- Në bashkëpunim me RMSA-në u arrit të sigurohet shërbimi i infermierisë për shtetasit e akomoduar në Qendër.
- Është realizuar procedura e marrjes në dorëzim të “Rikonstruksionit të Godinës së QKPA-së”, financuar nga Buxheti i Shtetit.
- Është realizuar procedura e marrjes në dorëzim të mobilimit të Godinave të QPA-së, financuar nga donatori UNHCR dhe RMSA.

## **PRIORITETET/OBJEKTIVA DHE MASAT ME RËNDËSI NË AKTIVITETIN E QPA-SË PËR VITIN 2022:**

1. Të mundësohet ndërtimi i murit rrethues të Qendrës së Pritjes për Azil për të rritur sigurinë dhe mirëqënien e jetës së shtetasve të cilët akomodohen në Qendër.
2. Të mundësohet ndërtimi i fushës së futbollit dhe këndit të lojrave për fëmijë në Qendrën e Pritjes për Azil për të rritur cilësinë e jetesës së shtetasve të akomoduar si dhe për të mundësuar integrimin dhe socializimin e tyre.

3. Të miratohen ndryshimet e kuotave financiare për shpenzime ditore për shtetasit e akomoduar në Qendër në mënyrë që të arrihet përmirësimi i standardeve të shërbimeve të ofruara.
4. Të miratohet një strukturë e re e Qendrës së Pritjes për Azil me staf multidisiplinar në mënyrë që të mbulohen të gjitha shërbimet dhe të rritet standarti i ofrimit të tyre.
5. Të bëhet i mundur organizimi i takimeve me partnerët mbi diskutime lidhur me tematikat e azilkërkuesve si dhe forcimin e bashkëpunimit midis tyre.
6. Të mundësohet realizimi i trajnimeve dhe kualifikimeve të stafit që kanë marrëdhënie të drejtpërdrejtë me azilkërkuesit/refugjatët, e cila do të mundësojë arritjen e standardeve europiane lidhur me cilësinë e ofrimit të shërbimeve brenda Qendrës.
7. Të mundësohet respektimi i masave të ndërmarra kundrejt parandalimit të përhapjes së sëmundjes së Covid-19.

**FALEMINDERIT!**

**DREJTOR**

**Ermir ALIÇKA**

